

INTERVISTË

Weber: Qeveria po e përdor Pakon e A

Fitim Gashi

PRISHTINË, MARS – Analisti politik i Këshillit Politik të Demokratizimit në Berlin, Bodo Weber, e ka quajtur përpjekje të dëshpëruar të Qeverisë, që Pakon e Ahtisaarit ta përdorë si mjet për të ushtruar presion në sigurimin e votave për ta kaluar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi.

“Këtë argument unë e shoh si një përpjekje të dëshpëruar të koalicionit qeverisës për të ushtruar presion mbi opozitën dhe deputetët që të votojnë në favor të marrëveshjes së demarkacionit. Por mendoj se kjo nuk do të funksionojë”, ka thënë Weber në intervistën dhënë “Kohës Ditore”. Sipas tij, mënyra se si është arritur marrëveshja me Malin e Zi, me mungesë të theksuar të transparencës, ka bërë që të ngrihen dyshime tek opozita. Por Weber mendon se kjo çështje nuk duhet të bëhet sepse që Kuvendi të hyjë në bllokadë afatgjatë. Gjermani Weber ka deklaruar se demarkacioni është kthyer në fushëbetejë, për shkak të asaj që ka ndodhur në vitin 2014, kur u pamundësua krijimi i Qeverisë nga koalicioni opozitar, si pasojë e vendimeve të motivuara “politikisht” nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Sa i përket nivelit të zbatimit të Pakos së Ahtisaarit, Weber ka thënë se institucionet nuk kanë arritur ta adresojnë çështjen kryesore, që ka qenë integrimi i veriut, si dhe vendosja e marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë. Sipas tij, kjo është arsyeja pse u instalua dialogu Kosovë-Serbi me ndërmjetësimin e Brukselit. Në një mënyrë ose tjetër, Weber mendon se dialogu është një lloj “Ahtisaari Plus”. “Por për fat të keq dialogu ka humbur vullnin gjatë katër viteve të fundit, për shkak të asaj se shumë compromise taktike nga ana e BE-së dhe SHBA-së, u dëshmuar të jenë kundërproduktive në afat të gjatë. Kjo mendoj se ka ndodhur edhe për shkak të mungesës së një masterplani strategjik”, ka theksuar Weber.

Demarkacioni - “fushëbetejë” pas dështimit të koalicionit opozitar

KD: Marrëveshja për shënimin e kufirit me Malin e Zi ka shkaktuar pakënaqësi të mëdha në Kosovë. Qeveria, edhe pse nuk i ka numrat në Kuvend, insiston që kësaj marrëveshjeje t’ia japë fuqinë e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërsa opozita dhe një grup ekspertësh pretendojnë se Kosova humb mijëra hektarë. Si i komentoni këto zhvillime?

Weber: Janë dy çështje që ndërliken me marrëveshjen e demarkacionit. Së pari, mënyra e fshehtë sipas së cilës koalicioni qeverisës negocioi marrëveshjen ka bërë që të ngrihen dyshime tek opozita. Gjithashtu, duket të jetë problematike cilësia e demarkacionit për të cilin është rënë dakord. Por kjo në vetvete nuk do të duhej të çonte

“Këtë argument (Pakon e Ahtisaarit për shënimin e kufirit me Malin e Zi v.j.) unë e shoh si një përpjekje të dëshpëruar të koalicionit qeverisës për të ushtruar presion mbi opozitën dhe deputetët që të votojnë në favor të marrëveshjes së demarkacionit. Por mendoj se kjo nuk do të funksionojë”, ka thënë analisti politik i Këshillit Politik të Demokratizimit, Bodo Weber

në atë që po ndodh- atë të bllokadës afatgjatë të kësaj çështjeje në Parlament. Bllokada mendoj se është shkaktuar për shkak të aspektit të dytë, të cilin e përmenda. Pra marrëveshja e demarkacionit është kthyer në një fushë beteje për atë që ka ndodhur në vitin 2014, parandalimin e koalicionit të atëherëshëm të opozitës për të formuar Qeverinë nga dy vendime të motivuara politikisht të Gjykatës Kushtetuese, që sollën koalicion të madh në pushtet, ku edhe qeveritë perëndimore kanë pasur dorë në të.

KD: Duke mbrojtur marrëveshjen e kufirit me Malin e Zi, Qeveria thotë se ajo është në përputhje me Planin e Marti Ahtisaarit, mbi bazën e së cilës është shpallur Pavarësia e Kosovës. Sipas pakos, kufijtë e Kosovës në ish-Jugosllavi definohej me ato vija që kanë qenë deri më 31 dhjetor 1988. Por, Pavarësia e mbikëqyrur ka përfunduar në shtator të vitit 2012. Kështu që, duke përmendur sot Pakon e Ahtisaarit, si njëfarë arsytimi ose presioni për ta votuar marrëveshjen e demarkacionit, por edhe për të shtyrë përpara edhe Asociacionin e komunave me shumicë serbe, a po vihet në dyshim kapaciteti i Kosovës që të veprojë plotësisht si shtet i pavarur?


Weber: Këtë argument unë e shoh si një përpjekje të dëshpëruar të koalicionit qeverisës për të ushtruar presion mbi opozitën dhe deputetët që të votojnë në favor të marrëveshjes së demarkacionit. Por mendoj se kjo nuk do të funksionojë.

KD: Me përfundimin e Pavarësisë së mbikëqyrur para pesë vitesh, a do të duhej që Plani i Ahtisaarit të trajtohej edhe sot si dokument i detyrueshëm?

Weber: Po, por kjo nuk do të thotë që nuk mund të lëvizet përtej Planit të Ahtisaarit, sidomos kur dihet se zbatimi i tij nuk ka qenë i plotë prej fillimit.

KD: Demokracitë perëndimore i kanë dhënë mbështetje Qeverisë në çështjen e demarkacionit. Por, në qoftë se Parlamenti refuzon të ratifikojë këtë marrëveshje, në kundërshtim me vullnetin e BE-së dhe SHBA-së, cilat mund të jenë pasojat?

Weber: Nuk jam edhe aq i sigurt nëse qëndron kjo. Mua më duket se qeveritë perëndimore kryesisht në parim e mbështesin Qev-



erinë, në kuptimin e asaj që ata duan që marrëveshja për demarkacion të miratohet në Parlament sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që Bashkimi Evropian të jetë në gjendje të vihet në lëvizje me Kosovën, duke i dhënë liberalizimin e vizave. Por duke gjykuar nga bisedat e kaluara që kam pasur me zyrtarë të ndryshëm, duket se ekziston një mirëkuptim për problemet që ekzistojnë me marrëveshjen e demarkacionit. Nëse miratimi i marrëveshjes vazhdon të mbetet i bllokuar, nuk do të ketë liberalizim të vizave dhe se kjo do të krijojë probleme serioze për procesin e integritetit të Kosovës në BE.

KD: Nëse demarkacioni me Malin e Zi është i bazuar në kufirin e ish-Jugosllavisë, çfarë do të thotë kjo për procesin e demarkacionit të kufirit me Serbinë, në të cilin duhet të hyjë Kosova?

Weber: Unë nuk mendoj se marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi do të përbente një përparësi ligjrisht të detyrueshme për çfarëdo negociate të ardhshme me Serbinë, sa i përket kufirit. Kjo kryesisht do të varet nga zhvillimet e mëtejshme politike,

Ahtisaarit si presion për demarkacionin



Analisti Bodo Weber ka thënë se mënyra se si është arritur marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi, me mungesë të theksuar të transparencës, ka bërë që të ngrihen dyshime tek opozita

si dhe angazhimi që do ta ketë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ta ndihmuar Kosovën që më në fund ta fitojë sovranitetin e plotë dhe me sukses të integrojë qytetarët e vet serbë në veri të vendit.

Ahtisaari u zbatua vetëm në formë, jo edhe në përmbajtje

KD: Kur jemi tek Plani i Ahtisaarit, dhe fakti se Pavarësia e mbikëqyrur ka përfunduar pesë vjet më parë, cila është analiza sot-deri në çfarë mase është zbatuar Ahtisaari dhe çfarë është lënë jashtë?

Weber: Unë nuk mendoj se ka nevojë në këtë moment dhe në këtë kohë për një analizë të detajuar të zbatimit të Ahtisaarit. Analiza e tillë është bërë në vitin 2012 nga ekspertët dhe 'think tanket' e ndryshme. Çështja kryesore, sa i përket mungesës së zbatimit të plotë të Ahtisaarit ishte, së pari, paaftësia për të zgjidhur problemin e integritetit të veriut, për të siguruar sovranitetin e plotë dhe integritetin territorial si dhe për

të vendosur marrëdhënie ndërshtetërore me Serbinë. Së dyti, dhe kjo është aq e rëndësishme sa pika e parë- Ahtisaari arriti të zbatohet vetëm në formë, por jo në substancë, që ishte synimi i saj kryesor - zgjidhjen e çështjes ndëretnike shqiptaro-serbe, të bazuar në parimin politik të vetëqeverisjes së fortë lokale, institucionale dhe politike, pra decentralizimi i udhëhequr nga ideja e qytetarëve aktivë që mbajnë zyrtarët dhe të zgjedhurit e tyre të përgjegjshëm. Ky parim nuk është bërë realitet, as në komunat me shumicë serbe në veri, as në jug të lumit Ibër, por as në shumicën e komunave me shumicë shqiptare.

KD: A dështoi integrimi i veriut gjatë Pavarësisë së mbikëqyrur, për faktin se pati nevojë që dialogu i Brukselit të vazhdojë së trajtuari këtë çështje. A do të thotë se dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja është në fakt një "Ahtisaari Plus" - një marrëveshje që do t'u jepte serbëve në Kosovë më shumë sesa është parashikuar nga Plani i Ahtisaarit, një nivel më të lartë të autonomisë, në shkëmbim të njohjes së Pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë?

Weber: Në një mënyrë ose tjetër, dialogu është një lloj "Ahtisaari Plus", që synon zgjidhjen e problemit të veriut. Por për fat të keq ka humbur vrullin gjatë katër viteve të fundit për shkak të asaj se shumë kompromise taktike nga ana e BE-së dhe SHBA-së u dëshmuuan të jenë kundërproduktive në afat të gjatë. Kjo mendoj se ka ndodhur edhe për shkak të mungesës së një masterplani strategjik. Kështu dialogu deri më tani ka dështuar për të arritur pranimin e Kosovës së pavarur nga ana e Serbisë, në mënyrë të qëndrueshme. Dhe kjo nuk ka arritur të ofrojë një strategji të modelit për t'u ofruar serbëve në veri diçka si "Ahtisaari Plus". Pra një ofertë që ndihmon integrimin e tyre në shtetin e pavarur të Kosovës, në një mënyrë që të mos krijojë diskriminime të reja kundër joserbëve në veri e as nuk krijon asnjë bazë të mundshme për minimin e ardhshëm të integritetit të shtetit të Kosovës. Kjo do të duhej të trasonte rrugën drejt demokracisë dhe një qeverisjeje të përgjegjshme për serbët dhe shqiptarët në tërë Kosovën.

© KOHA Ditore